

PROCESVERBAL
nga seanca e 34-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 26.10.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, L Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë : /

Z. Petrushevski hapi seancën e 34-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Seanca filloi në orën 14:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, salla e konferencave në katin e 2-të.

Z. Petrushevski njoftoi se në rendin e ditës të propozuar do të shtohet edhe një Pikë nr.5 me titull – Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për pagesë të mjeteve për qasje në Sistemin e shpërndarjes së internetit të Regjistrimit Qendror, për të cilin është dorëzuar edhe materiali.

Këshilli i Agjencisë njëzëri me 5 vota “pro”, (z.Jançeski nuk ishte i pranishëm në momentin e votimit), miratoi si në vijim të korigjuar:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga vazhdimi i parë i seancës së 32-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 16.10.2023.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 33-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 16.10.2023.
3. Propozim–vendim për moshapjen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit digjital tokësor.
4. Propozim vendim për ndryshimin e strukturës së pronësisë të SHTR LAJF RADIO.
5. Propozim për dhënien e miratimit për marrjen e vendimit për pagesën e mjeteve për qasje në Sistemin e shpërndarjes së internetit të Regjistrimit Qendror.
6. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi dhe njëzëri me 5 vota “pro” (z.Jançeski nuk ishte i pranishëm në momentin e votimit), miratoi Procesverbalin e propozuar nga vazhdimi i parë i seancës së 32-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 16.10.2023, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri, me 6 vota “pro”, miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 33-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur me datë 16.10.2023, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Z. Trajçevski shpjegoi Propozim - vendimin për moshapjen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit digjital tokësor. Ai ka shpjeguar se në furnizimin publik të realizuar më parë për përgatitjen e Studimi me kërkesë të TV 24 Vesti, sipas rezultateve të studimit, Këshilli i Agjencisë miratoi Vendim për refuzimin e kërkesës së parashtruesit. Transmetuesi ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankesë në Gjykatën Administrative, e cila më pas miratoi Akvendimin që të rishqyrtohet Vendimi i Këshillit, respektivisht të miratohet vendim i ri nga Këshilli. Në janar të këtij viti, Këshilli miratoi Konkluzionin që pas publikimit të rezultateve të Analizës së Tregut për vitin 2022, Agjencia sipas detyrës zyrtare do të publikojë thirrje publike për përgatitjen e një studimi për nevojat e shpalljes së konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit digjital tokësor. Ai tha se tani Studimi është përgatitur dhe sipas gjetjeve të tij nuk ka arsyetim për shpalljen e konkursit publik.

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva ka shpjeguar se Studimi për përcaktimin e arsytimit për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim televiziv në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit digjital tokësor përbëhet nga tri pjesë, përkatësisht analiza ekonomike, analiza e ofertës ekzistuese mediatike dhe pjesa e tretë është një analizë e nevojave të publikut, respektivisht e kënaqëshme nga kualiteti i përmbajtjeve programore. Qëllimi i studimit është që nëpërmjet këtyre tre aspekteve të përcaktohet nëse ekziston arsyetim për shpalljen e konkursit ashtu siç është përcaktuar në ligj, nga pikëpamja e qëllimeve, pra të mundësohet zhvillimi, pluralizmi në treg dhe nga këndvështrimi i nevojave të publikut. Nga njohuritë që dolën nga studimi është se asgjë nuk ka ndryshuar për mirë nga studimet e mëparshme nga aspekti ekonomik, përkundrazi situata është përkeqësuar në drejtim të qëndrueshmërisë financiare të mediave, e cila gjithashtu është konstatuar në dy Raporte mbi progresin e vendit (raportet e progresit) ku vihet një theks i veçantë në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare, për të cilën ai citoi “në treg ka një numër të madh mediash, duke pasur parasysh konsumin mjaft të ulët, financim në dispozicion, qëndrueshmëria financiare paraqet një sfidë të rëndësishme”. Kjo është diçka që të gjithë e njohin. Analiza e ofertës ekzistuese tregon uniformitet, sepse të 5 televizionet në nivel shtetëror janë të një formati të përgjithshëm ndërsa publiku kërkon programe për fëmijë, edukative, seriale artistike cilësore, sport. Dhe nga kjo rezulton se nuk ka arsyetim për dhënien e lejes për televizion me format të përgjithshëm. Nëse jepet leja, oferta aktuale do të dyfishohet, numri i mediave do të rritej dyfish dhe meqënëse në të gjitha Raportet puna e Agjencisë është vlerësuar shumë mirë, në këtë rast

nëse vepohet kundër konkluzioneve të Studimit, do të jetë fakt që Agjencia nuk merr parasyslllogarinë e qëndrueshmërisë financiare të tregut.

Z. Petrushevski përkujtoi se për këtë temë Këshilli ka diskutuar në detaje në janar të këtij viti. Tani edhe në materialet pas pikës është cekur detajisht kronologjia e ngjarjeve. Ky proces vazhdon prej disa vitesh, nga viti 2020 e deri më tani. Propozimi nga Shërbimi Profesional dhe nga drejtori është i thjeshtë, pra të mos shpallet konkurs për shkak të konstatimit kryesor në Studim se nuk ka arsye për shpalljen e tij. Ai lexoi Studimin që tregon se gjendja ekonomike në vend në tërësi është mjaft e keqe, përfshirë edhe median, e cila është përkeqësuar më tej nga situata me Covid pandeminë para disa vitesh dhe sërish nga lufta në Ukrainë. Ajo që nuk shkruan në Studim dhe nuk mund ta shkruante është se muajin e kaluar filloi një luftë e re në botë, dhe ajo është midis Izraelit dhe Hamasit, e cila nuk jep shpresë se diçka do të zgjidhet shpejt për mirë. Ne si qytetarë nuk kemi nevojë për studime për të parë gjendjen e keqe ekonomike në Maqedoni, mjafton të shkosh në një dyqan ushqimor dhe do të shohësh se sa janë rritur çmimet e produkteve nga një vit më parë, të paktën për 50%. Gjithashtu mund të konkludohet se disa media të vogla çdo vit heqin dorë nga aktiviteti i tyre për arsye financiare. Në atë drejtim, ai tha se propozimi është i qartë dhe pranor, që ky Studim të mos publikohet, se numri aktual i mediave është i mjaftueshëm, sidomos në nivel kombëtar. Nëse kërkesa është për media të vogël lokale ku nuk ka, ndoshta do ta mbështes, por për nivel kombëtar jo. Përveç kësaj, nuk dihet dhe nuk ka asnjë garanci se kush do të marrë lejen sepse konkursi është i hapur për të gjithë ata që duan të konkurrojnë dhe i plotësojnë kushtet, që do të thotë se ekziston mundësia që të jetë dhe ndonjë televizion i ri dhe jo ai që është aplikant për televizion. Reale është mundësia që nëse fiton një subjekt tjetër do të rritet numri i mediave shtetërore. Ai e mbështet plotësisht propozimin e shërbimit dhe drejtorit dhe do të votojë që të mos shpallet ky konkurs publik.

Këshilli i Agjencisë me 5 vota "pro" dhe një abstenim nga z. Fidanoski, miratoi vendim që të mos shpallet konkursi publik për dhënien e lejes për shërbime programore televizive me: formati të përgjithshëm kryesisht argëtues, format të përgjithshëm kryesisht informativ dhe format të përgjithshëm në të cilin llojet e programeve që përfaqësojnë i kryejnë të tre funksionet mediatike, në nivel shtetëror nëpërmjet multipleksit digjital tokësor, sepse me Studimin nr.03-3610/3, datë 20.10.2023, u konstatua se nuk ka arsye për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për shërbime programore televizive për formatet e përcaktuara të shërbimeve programore televizive.

Për vendimin e marrë të njoftohet Gjykata Administrative e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe pala e interesuar për dhënien e lejes.

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, të publikojë vendimin e mësipërm në ueb faqen e Agjencisë.

Z. Petrushevski tha se shpreson që në vendin tonë dhe në botë gjendja financiare do të përmirësohet dhe ndoshta për një vit do të ketë mundësi për shpalljen e këtij konkursi publik. Është gjithashtu e rëndësishme të thuhet se aplikanti duhet të ndryshojë kërkesën për formatin televiziv, i cili mungon në vendin tonë.

Pika 4

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, sqaroi Propozim-vendimin për ndryshimin e strukturës së pronësisë të

SHTR LAJF RADIO. Ajo shpjegoi se njoftimi i dorëzuar është i plotë dhe i rregullt. Bëhet fjalë për ndryshimin e strukturës së pronësisë në bazë të procedurës së verifikimit. Pronari i këtij radiostacioni ka vdekur dhe si trashëgimtar paraqitet bashkëshortja e tij. Janë bërë verifikime në Regjistrin Qendror dhe është konstatuar se nuk ka pengesë ligjore që ajo të jetë pronare. Në atë drejtim është dhe propozimi për miratimin e ndryshimit të kërkuar.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka miratuar Vendim me të cilin lejohet ndryshimi i strukturës së pronësore të SHT LAJF RADIO SHPKNJP Shkup, me tekstin siç është propozuar në vendim.

Ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë të SHTR LAJF RADIO SHPKNJP Shkup nuk krijojnë koncentrim të paligjshëm mediatic në kuptimin e LSHMAAV, respektivisht ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 nga Ligji i njëjtë.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm ta publikon në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 5

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr. Magdalena Davidovska Dovleva, ka sqaruar Propozimin për dhënien e miratimit për miratim të vendimit për pagesën e mjeteve për qasje në Sistemin e shpërndarjes së internetit të Regjistrin Qendror. Ajo shpjegoi se ky sistem funksionon në bazë me pripejd (parapagesë), pra paguhen mjetet dhe më pas si përdoren (shfrytëzohen) shërbimet zvogëlohet shuma e paguar. Kërkesa aktuale është në shumë prej 40.000,00 denarë , ndërsa pagesa e fundit është bërë në shkurt të këtij viti në shumë prej 30.000,00 denarë. Që atëherë e deri më tani, këto mjete (fonde) janë shpenzuar si për shembull, për kontrollimin e paligjshëm të përqendrimit mediatic gjatë ndryshimit të strukturës së pronësisë, më pas Spektori për çështje juridike i përdor për të kontrolluar gjendjen vijuese kur shqiptohen masat, ndonjëherë është më intensiv përdorimi ndonjëherë jo, por gjithmonë mjetet (fondet) zgjasin për periudhë më të gjatë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratimin që drejtori i Agjencisë të miraton Vendim me të cilin miratohen mjetet (fondet) në shumë prej 40.000,00 denarë me qëllim të mundësimin të qasjes së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në të dhënat e Sistemit të shpërndarjes së internetit në Regjistrin Qendror të RMV-së, i cili do të krijojë kushte për përmbushjen në vijim të detyrimeve që për Agjencinë e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale janë paraparë në igjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18 , 248/18, 27/19 dhe “ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut ” nr.42/20, 77/21 dhe 154/23) dhe në Ligjin për Media (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.184/13 dhe 13/14).

Mjetet e mësipërme sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023.

Pika 6

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-3836/5

06.11.2023

Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike

Audio dhe Audiovizuale

Kryetari i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.